



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9226 Prot.

Roskovec, më 26, 11 2024

VENDIM

NR 71 .DATË 28 . 11 .2024

“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b” dhe nënpika 1.3 shkronja “b”, si dhe nenit 54 shkronja “f” të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit Nr.9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” i ndryshuar, Kreu III, Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” ; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 132, datë 07.03.2018“ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” i ndryshuar, Ligjit Nr.9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ,Ligjit Nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKM Nr. 607, datë 29.07.2020 “Për tarifatat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar, Ligjit 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8098 datë 23.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8626 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar, Ligjit Nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e Invalidit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit” i ndryshuar, Ligjit 57/2020 datë 28.05.2020 “Për pyjet” i ndryshuar, Ligjit Nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.10279

datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për manaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të miratojë strukturën dhe nivelet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 që janë paraqitur si më poshtë:

KAPITULLI I

TAKSAT VENDORE

1.1 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë million) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza e taksës/tatimi : Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) million lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

1.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme , në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari apo bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë të cilat nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- *Taksa mbi tokën bujqësore*
- *Taksa mbi ndërtesën*
- *Taksa mbi truallin*

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë(ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësoj sipërfaqen e taksueshme.

I.2.1Taksa mbi ndërtesat

Baza e taksës: Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.132, datë 7.3.2018 i ndryshuar.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që shfrytëzohen për banim/strehim në Bashkinë Roskovec është 30,000 lekë/m² sic përcaktohet në VKM Nr.132, datë 7.3.2018 i ndryshuar,
2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njësive administrative.
5. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësive administrative. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.”
6. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

7. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.
8. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat ju bashkuan njësitë të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 115/2014, reduktohet 10 (dhjetë) për qind.
9. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

Niveli i taksës mbi ndërtesat: Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Nënkategoritë e ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:

1. Ndërtesa, e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
2. Garazhet e mbyllura;
3. Bodrumet;
4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

“Ndërtesa të tjera” përfshihen:

1. Ndërtesa për tregëti dhe shërbime
2. Parkim të mbuluar dhe bodrume
3. Parkim i hapur
4. Ndërtesa për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme
5. Ndërtesat që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Zyra e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Mbledhja e kësaj takse bëhet me agjent tatimore të përcaktuar nga NJQV.

Përfshihen nga pagesa për taksën e ndërtesës së banimit familjet:

1	Me ndihmë ekonomike	Po
2	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
3	Të verbërit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Veteranët e luftës	Po

Përfshitimi bëhet kur përfituesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor. Ky përfshitim vlen kur tatimpaguesi nuk merret me aktivitet privat.

Përfshitime: Përfshihen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";
- h) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë
- i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës : Detyrimi për familjet dhe bizneset llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë arkës, Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për ndërtesat që shfrytëzohen për veprimtari ekonomike dhe deri në 31 dhjetor për familjarët.

Shpërndarja e njoftim detrimëve të taksapagueseve do të bëhet :

1.Me postë

2.Në mënyre elektronike kur taksapaguesi e ka pranuar këtë formë komunikimi

3. Me libër dore nga punonjës të bashkisë

I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: **“Tokë bujqësore”** është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë. Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar , në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqiten si më poshtë:

Kategorit mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore			
		Bashkia	Kuman	Strum	Kurjan
I	Lekë/ha/vit	5600	5600	5600	5600
II	Lekë/ha/vit	4900	4900	4900	4900
III	Lekë/ha/vit	4200	4200	4200	4200
IV	Lekë/ha/vit	3600	3600	3600	3600
V	Lekë/ha/vit	3000	3000	3000	3000
VI	Lekë/ha/vit	2400	2400	2400	2400
VII - X	Lekë/ha/vit	1800	1800	1800	1800

Detyrimi për pagesë : Detyrimi mbi taksën e tokës bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga zyra e taksave dhe shlyhet në arkë, në bankat e nivelit të dytë ose Postën Shqiptare në bazë të një kontrate të lidhur me këtë të fundit.

- ❖ **Për taksën e tokës bujqësore të zbritet 30% e detyrimit të vitit 2025 , për arkëtimet e kryera deri më 30.06.2025.**
- ❖ **Për tokat bujqësore të cilat ndodhen brenda argjinaturës të lumit Seman në fshatrat Jagodinë, Suk 1 dhe Arapaj që përmbyten, do të paguhet 70% e vlerës së detyrimit për gjatë gjithë vitit.**
- ❖ **Përjashtim :**

Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore:

- a. sipërfaqja e tokës bujqësore që mbillet me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- b. Përsonat si më poshtë:

1	Me ndihmë ekonomike	Po
2	Tetraplegjik, paraplegjik	Po

3	Të verbërit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Veteranët e luftës	Po

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Strukturat e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, është zyra e të ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë Roskovec ngarkohet për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar ndryshime të herëpashershmë dhe ia përcjell këtë informacion Zyres së të Ardhurave për llogaritjen e detyrimit.

I.2.3 Taksa mbi truallin

Përkufizimi: Truall është sipërfaqe toke, jo bujqësore, jo hapsirë publike që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si mëposhtë :

Taksa mbi truallin	Njesia	Niveli i taksës mbi truallin
Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m ² /vit	0.14
Për qëllim biznesi	Lekë/m ² /vit	12

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Detyrimi për familjet dhe bizneset llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë arkës, Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për truallin për qëllim biznesin dhe deri në 31 dhjetor për familjarët.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 250 m².

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit.

I.3 Taksa e fjetjes në hotel

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për një person.

Niveli i taksës paraqitet si më poshtë:

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel 4-5 yje	Lekë/natë qëndrimi /për person	105
Bujtine, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese	Lekë/natë qëndrimi /për person	35

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

1.3 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
	Në % të çmimit të shitjes për m ² ose e vlerës së preventivit	Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industris apo për përdorim publik.	4%- 8%	4%	4%

Baza e taksës: Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “ Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
	Në % të vlerës së investimit	Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera

Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër	1-3%	2%	2%
Ndërtesa që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin	jo më shumë se 1 %	1%	1%
Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare etj.	0.1 por jo me pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit	0.1	0.1
Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5 e vlerës së investimit	0.5	0.5

Baza e taksës : Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit. Detyrimi i taksës i takon investitorit.

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjen përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqen respektive.

Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Drejtoria e të Ardhurave. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Roskovec, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Struktura për vjeljen e taksës është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Roskovec.

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:

- investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".
- investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile.

1.4 Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-së Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekt fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, **kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit**, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3 % e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Drejtoria e Urbanistikës, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr.575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provoj se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4,5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Urbanistikës. Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

I.5 Taksa e kalimit e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Bashkia Roskovec
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100
Ndërtesa të tjera për tregëti dhe shërbime	Lekë/m ²	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon e drejta e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose I për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Roskovec, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Ngarkohet Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ZRPP.

I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Baza e taksës: Është lloji i mjetit të transportit rrugor

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të rregjistruara sipas njësive vendore, 25% të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon Bashkisë Roskovec në llogari të degës së thesarit.

I.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës : Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industri minerare, sipas një marrëdhënie kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentën minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nën toka.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin që ai shet produktin. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë Degët e doganave në rrethe ngarkohen me arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, 5% e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Roskovec në degën e thesarit.

.I.8 Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamje ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe shërbejnë për qëllime identifikimi.

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	B.Roskovec
I.	Taksë tabelle per qëllime identifikimi, të trupezuara ose jo, brënda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tjereve (ku shenohet emri dhe/ose aktiviteti I biznesit)		
a	deri në 2m	lekë/m2/vit	0
b	mbi 2m2 deri 10m2		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë/m2/vit	7000
	me ndricim të thjeshtë	lekë/m2/vit	11500
	elektronike	lekë/m2/vit	15000
c	mbi 10m2 deri 20m2		
	e thjeshte pa ndricim	lekë/m2/vit	5950
	me ndricim të thjeshtë	lekë/m2/vit	9775
	elektronike	lekë/m2/vit	12750
ç	mbi 20m2 deri 40m2		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë/m2/vit	3850
	me ndricim të thjeshtë	lekë/m2/vit	6325
	elektronike	lekë/m2/vit	8250
d	mbi 40m2		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë/m2/vit	2800
	me ndricim të thjeshtë	lekë/m2/vit	4600
	elektronike	lekë/m2/vit	6000
II.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim		
	Tabela identifikuese	lekë/m2/vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri ne tavanin maksimal 35m2		
	e thjeshtë pa ndricim	lekë/m2/vit	13500

	elektronike	lekë/m ² /vit	2700
IV.	Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura,panaire,spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /vit	1000

Shënim: Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10m² do ti shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë e thjeshtë 15m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet $(10m^2 * 7000lekë) + (5m^2 * 5950 lekë) = 70000 + 29750 = 99750lekë/vit$. E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20m² dhe 40m².

Për subjektet që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë. Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35m² do të konsiderohet sikur është 35m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Roskovec. Detyrimi për bizneset llogaritet nga Zyra e të Ardhurave dhe shlyhet me arkë, pranë Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për biznesin .

KAPITULLI II TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementet :

- Llojit të shërbimit , baza e taksueshme , kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohë e kryerjes së tyre, kushtet lehëtsuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

II.1 Tarifë Regjistrimi Biznesi

Tarifa e regjistrimit paguhet nga bizneset kur regjistrohen për herë të parë pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore .Subjekti që ka më shumë se dy vendndodhje paguan vetëm për adresën ku ka selinë kryesore te aktivitetit. Taksapaguesi është i detyruar të regjistrojë çdo vendndodhje të biznesit pranë Bashkisë Roskovec që në momentin që e çelë. Regjistrimi për herë të parë bëhet përpara se taksapaguesi të fillojë aktivitetin e biznesit të tij.

Gjatë këtij regjistrimi taksapaguesi detyrohet të japë informacionin e mëposhtë:

I. Ekstraktin nga Qendra Kombëtare e Biznesit

- II. Fotokopje të kartës së indetitetit
 III. Adresën e Vendndohjes së biznesit
 IV. Llojin e biznesit që kryen në atë vendodhje
 V. Kontratë qeraje ose dokument hipotekor për vendin ku ushtron aktivitetin

Çdo të dhënë ose dokument tjetër , që mund të përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financës:

Tarifë regjistrimi biznesi	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Sub.fizik vendas/huaj	12000 lekë	10000 lekë	10000 lekë	10000 lekë
Sub.juridik vendas/huaj	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë
Ambulant	2000 lekë	2000 lekë	2000 lekë	2000 lekë
Sub. Fizik që nuk kanë seli por që ushtrojnë aktivitet	12000 lekë	12000 lekë	12000 lekë	12000 lekë
Sub. Juridik që nuk kanë seli por që ushtrojnë aktivitet	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

II.2 Tarifa e Tregut

Lloji i Tarifave	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Shitës mishi në markato	600 lekë/vend	0	0	0
Zënie vendi për gjedhë	100 lekë/vend	0	0	0
Zënie vendi për shpendë	10 lekë/vend	0	0	0
Zënie vendi për të imta	30 lekë/vend	0	0	0
Tarifë tregu	35 lekë/m ²	0	0	0

II.3 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Përkufizimi : Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet , personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brënda territorit të Bashkisë Roskovec dhe njësisive të saj administrative, të cilëve u ofrohet ky shërbim.

Niveli i tarifës së pastrimit : Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet

FAMILJARËT (për familje)	Lekë /vit
Njësia Administrative Roskovec	2000
Njësia Administrative Strum	1200
Njësia Administrative Kuman	1200

Njësia Administrative Kurjan	1200
------------------------------	------

Përrjashtohen nga pagesa për tarifën e pastrimit familjet:

1	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
2	Me ndihmë ekonomike	Po
3	Të verbërit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Të përndjekurit politik	Po
6	Veteranët e luftës	Po
7	Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes);	50% të tarifës
8	Kryefamiljarët gra (të ve ose të divorcuara)	50% të tarifës
9	Kryefamiljarë pensionist që kanë persona në ngarkim të tyre që janë të paafte për punë.	50% të tarifës

Përrjashtimi bëhet kur përfituesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor.

Për qytetarët e regjistruar në gjendjen civile si banor të qytetit të Roskovec por që jetojnë në një shtet tjetër për pagesën e tarifës së pastrimit duhet të sjellin:

1. Nje vërtetim që banojnë ose janë resident në shtetin e huaj
2. Dhe /ose fotokopje të pashaportës

*Në bazë të vlerësimit të dokumentacionit të sjellë pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore do të bëhet dhe përrllogaritja e detyrimit. Baza e llogaritjes së detyrimit do të jetë periudha ditore e qëndrimit (Nr. ditëve * tarifa e pastrimit vjetore/365) . P.sh 15*2000/365=82.2 lekë*

Tabela 2. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset dhe institucionet

Nr	Bizneset(sipas llojit të aktivitetit)	Qyteti Roskovec	Nj.A Strum	Nj.A Kuman	Nj.A Kurjan
1	Fruta-Perime	18000	12000	12000	12000
2	Ushqimore e bulmetore	18000	15000	15000	15000
3	Mish,peshkë	18000	15000	15000	15000
4	Artikuj të ndryshëm me pakicë	15000	12000	12000	12000
5	Market	22500	15000	15000	15000
6	Supermarket	30000	22500	22500	22500
7	Artikuj Industrial	22500	15000	15000	15000
8	Gazet & Kioska	13500	13500	13500	13500
9	Farmaci	18000	18000	18000	18000

10	Klinik Dentare	21000	21000	21000	21000
11	Bar-Bufe				
a.	Subjekte 40m2	16500	10500	10500	10500
b.	Subjekte 40m2-100m2	19500	13500	13500	13500
c.	Subjekte 101m2-200m2	22500	22500	22500	22500
d.	Restorant	34500	34500	34500	34500
12	Byrektore ,Fast- Food	15000	15000	15000	15000
13	Berber	15000	12000	12000	12000
14	Parukeri	15000	12000	12000	12000
15	Lojra fati	60000	60000	60000	60000
16	Lojra elektorike për femije	15000	10500	10500	10500
17	Agjensi Sigurimesh	22500	22500	22500	22500
18	Kompani në fushën e komunikimit elektorik	52500	30000	30000	30000
19	Shërbime monetare (banka)	120000	60000	60000	60000
20	Zdrukthari	52500	30000	30000	30000
21	Punime durale	22500	22500	22500	22500
22	Materiale,Ndërtimi e Mermeri	52500	30000	30000	30000
23	Prodhime brumërash	60000	30000	30000	30000
24	Elektroshtëpiake	25500	25500	25500	25500
25	Tregëtim Karburantesh në Rrugë Nacionale	90000	90000	90000	90000
26	Tregëtim Karburantesh nëpër fshatëra		45000	45000	45000
27	Përpunime qumështi	45000	45000	45000	45000
28	Pikë grumbullimi fruta perime	45000	45000	45000	45000
29	Mulli I thjeshtë	22500	22500	22500	22500
30	Përpunim drithi	45000	45000	45000	45000
31	Fabrikë përpunim ulliri	45000	45000	45000	45000
32	Farmacitë Bujqësore	18000	18000	18000	18000
33	Parkime (24 ore)	15000	15000	15000	15000
34	Mjete Bujqësore	9000	9000	9000	9000
35	Riparime të ndryshme (elektronike)	13500	10500	10500	10500
36	Bilardo,Kalceto	27000	22500	22500	22500
37	Rrobaqepësi	19500	19500	19500	19500
38	Servis makinash	33000	33000	33000	33000
39	Shërbime të ndryshme(makinash,motorcikleta, bicikleta)	18000	15000	15000	15000
40	Servis makinash+varrezë makinash	60000	60000	60000	60000

a.	Transport udhëtarësh	0	0	0	0
b.	Për taxi(4+1)	4500	4500	4500	4500
c.	Autobuza (9-30)	6750	6750	6750	6750
d.	Autobuza (30-50)	7500	7500	7500	7500
42	Transport malli	0	0	0	0
